

## Dokumentimi dhe mbajtja e llogarive për qëllime tatimore, për subjektet e TVSH-së apo Tatimit mbi Fitimin

Personi i tatueshëm është i detyruar të mbajë regjistrime dhe të përdorë dokumentacionin tatimor, në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor.

Dokumentacion tatimor, në kuptim të dispozitave ligjore fiskale, do të vlerësohen **faturat tatimore me TVSH, faturat e thjeshta tatimore, dëftesat tatimore, faturat e shoqërimit dhe çdo dokument tjetër tatimor**, miratuar, përkatësisht, nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë apo Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve për dokumentimin e veprimtarisë tregtare të tatimpaguesit.

### ❖ **Faturat tatimore të shitjes me TVSH, kuponi tatimor dhe dëftesat tatimore**

Një person i tatueshëm, i cili ushtron veprimtari ekonomike e tregtare dhe është subjekt i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar apo i Tatimit mbi Fitimin, kur kryen një furnizim mallrash apo shërbimesh, në momentin e furnizimit, është i detyruar të lëshojë faturë tatimore të TVSH-së në lidhje me atë furnizim, për çdo person të tatueshëm që merr furnizimin. Personi i tatueshëm, i cili merr furnizimin mund të jetë një person tjetër i tatueshëm, subjekt i TVSH-së apo i Tatimit mbi Fitimin, një person i tatueshëm subjekt i taksës vendore mbi biznesin vogël, një organizatë jofitimprurëse, fondacion, njësi zbatimi projektsh, ent publik kombëtar apo vendor, organizatë politike apo çdo organ tjetër i ngjashëm me to.

Forma dhe përmbajtja e faturës tatimore të TVSH-se është siç përcaktohet në ligjin "Për TVSH-në" dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të këtij ligji.

- Personi i tatueshëm shitës me pakicë, subjekt i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar apo i Tatimit mbi Fitimin, është i detyruar gjithashtu, përveç kuponit tatimor, të lëshojë një faturë tatimore me TVSH, kur vlera e çdo furnizimi të kryer për blerësin, pavarësisht nga statusi i këtij të fundit, është më e madhe se 40,000 lekë, përfshirë TVSH-në. Për çdo furnizim të tillë, të bërë për individët konsumatorë jotregtarë, në faturën e lëshuar nga shitësi paraqitet detyrimisht emri, mbiemri dhe adresa e blerësit.
- Personi i tatueshëm shitës me pakicë, subjekt i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar apo i Tatimit mbi Fitimin, është i detyruar gjithashtu që, përveç kuponit tatimor, të

lëshojë një faturë tatimore me TVSH, pavarësisht nga vlera e furnizimit, në rastet kur marrësi i furnizimit është person i tatueshëm dhe kërkon faturë tatimore për nevoja biznesi apo kur marrësi i furnizimit, edhe kur nuk është personi i tatueshëm, e kërkon faturën.

- Personi i tatueshëm, subjekt i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar apo i Tatimit mbi Fitimin, është i detyruar të lëshojë faturë tatimore të TVSH-së edhe për çdo furnizim mallrash e shërbimesh të kryer për organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme me to, që kryejnë veprimtari të ndryshme.

## Kuponi tatimor

Lëshohet nga të gjithë personat e tatueshëm, shitës me pakicë, subjekte të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, të cilët sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 781, date 14.11.2007, janë të detyruar të pajisen me arkë regjistruese. Forma dhe përmbajtja e kuponit tatimor është përcaktuar në VKM-në nr. 781, datë 14.11.2007.

## Dëftesa tatimore

Lëshohet nga të gjithë personat e tatueshëm shitës me pakicë, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo të tatimit mbi fitimin, të cilët nuk janë të pajisur me arke regjistruese ose që, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 781, date 14.11.2007, në raste të veçanta mund të mos lëshojnë kupon tatimor. Rolin e dëftesës tatimore mund ta luajnë edhe dokumente të tjera të miratuara në akte të tjera ligjore apo nënligjore në fuqi, si për shembull: biletat e transportit urban, interurban apo ndërkombëtar të udhëtarëve, kuponët e lëshuar nga makinat elektronike të fatit, biletat e lojërave të fatit të miratuara nga ministria përkatëse, etj..

Kuponi tatimor dhe dëftesa tatimore nuk mund të shërbejnë si dokumente justifikuese të shpenzimeve të zbriteshme të biznesit për blerësin, përveç rastit kur kuponi tatimor shoqërohet edhe me faturë tatimore të TVSH-së.

Në rastet e furnizimeve të marra nga individë të ndryshëm, të cilët nuk kanë cilësinë e tregtarit, personi i tatueshëm mund të lëshojë për veten e tij, një faturë tatimore në përputhje me dispozitat e pikës 53 të udhëzimit përkatës. Kjo faturë duhet të vërtetohet nga individ i furnizues nëpërmjet nënshkrimit dhe të dhënave të tjera identifikuese të tij, si : emër mbiemër, numër i pasaportës, etj..

Personi i tatueshëm, subjekt i TVSH-së apo i Tatimit mbi Fitimin, si marrës i furnizimit është i detyruar që të shënojë në faturën e përgatitur për veten e tij edhe numrin e tij të identifikimit.

Fatura e lëshuar si me sipër nga vetë blerësi, person i tatueshëm si subjekt i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar apo i Tatimit mbi Fitimin, është dokument që justifikon shpenzimet e zbritshme të biznesit për efekt të llogaritjes së Tatimit mbi Fitimin.